



KD. Nr. 57/2017

Datë: 18.08.2017

Bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë, Gazeta Zyrtare Nr. 17, të dt. 01. 10. 2007, Këshilli Drejtues në përbërje: Selman Jusufi – Kryesues, Zethane Gimolli Bahtiri, Ilir Gjocaj, Visar Krusha dhe Yll Çitaku, në takimin e mbajtur me datë, 18 gusht 2017, nxjerrë:

V E N D I M

1. Emërohen Anëtarët e Komisionit të Vizionimit, të Qendrës Kinematografike të Kosovës (në tekstin e më tejme QKK), në përbërje të pesë anëtarëve. Katër anëtarët e parë me mandat një vjeçar, kurse i pesti do të jetë ad-hoc.
Anëtarët e Komisionit të Vizionimit, për filmat e prodhuar në Kosovë, janë:
 1. Veton Nurkollari
 2. Linda Gusia
 3. Imer Mushkolaj
 4. Birol Urcan
 5. Person ad-hoc
2. Drejtori i QKK-së vendosi që lartësia e kompensimit për secilin film të vizionuar të shkurtër është pesëmbëdhjetë (15) euro ndërsa, filmi i gjatë tridhjetë (30) euro.
3. Shfaqësit, distributorët dhe festivalet e filmit obligohen ta respektojnë kategorizimin e filmave, në të kundërtën do të sanksionohen.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i QKK-së e ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke u bazuar në nenin 31 dhe 50, të Ligji Nr. 2004/22 për Kinematografinë.

Sipas nenit 31 pika f, të Ligjit për kinematografi, kompensimi/shpërblimi për shqyrtimin dhe vizionimin e filmave u caktua nga drejtori i QKK-së.
Lartësia e kompensimit për secilin film të vizionuar të shkurtër është pesëmbëdhjetë (15) euro ndërsa, filmi i gjatë tridhjetë (30) euro.

Bazuar në nenin 9, par. 9.1. dhe 9.2 të Ligjit për kinematografi, Komisioni i Vizionimit ka të drejtë të jep leje për shfaqjen publike të filmit sipas kategorive, të cituar:

"9.1. Për çdo film vendës apo të huaj që synohet të shfaqet publikisht, para se të ketë shfaqjen e parë në Kosovë, distributori, perkatësisht shfaqësi duhet të merr lejen për shfaqjen publike të filmit.

9.2. Lejen nga paragrafi i mësipërm, e jep Komisioni i Vizionimit i QKK."

dhe sipas nenit 10, parag. 10.1. e cituar: *"10.1. Komisioni i Vizionimit të QKK jep leje në kuptim të nenit 9 të këtij ligji sipas kategorive të mëposhtme:*

a) kategoria 'A' – kur filmi lejohet për të gjitha moshat dhe pa kufizim në aspektin e kohës të projektimit publik,

b) kategoria 'B' – kur filmi lejohet për të gjithë banorët mbi 14 vjeç,

c) kategoria 'C' – kur filmi lejohet për të gjithë banorët mbi 18 vjeç,"

Gjithashtu Komisioni i Vizionimit nuk ka të drejtë të jep leje në rastet sipas nenit 10 parag.10.2 dhe 10.3. të cituar:

"10.2. Nuk jepet leje për filmat që nxitin ose mbështetin pornografinë, prostitucionin, përdorimin e narkotikëve, urrejtjen etnike, raciale apo religjioze, terrorizmin si dhe aktivitete tjera kriminale."

"10.3. Filmat e pajisur me leje që përmbajnë skena të dhunës së theksuar, skena tmërri, skena të dhunës në familje ose të dhunës a të keqtrajtimit të fëmijëve, mund të shfaqen për publik pas orës 22,00."

Shfaqësit, distributorët dhe festivalet e filmit, për shfaqjen e filmave të huaj duhet të respektojnë kategorizimin nga vendi i origjinës apo nga distributori Ndërkombëtar.

Kinematë dhe festivalet, kategorizimin duhet ta bëjnë publik, si dhe mos të lejojnë qasjen në shfaqje personave nën moshën e kategorizuar.

Shfaqësit, distributorët dhe festivalet e filmit obligohen ta respektojnë kategorizimin e filmave, në të kundërtën do të sanksionohen në bazë të neni 56, të Ligjit për kinematografi.

z. Selman Jusufi

Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- Shfaqësit, distributorët dhe festivalet e filmit;
- Arkivit të QKK-së.